



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.105

7 gusht

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MF nr.13, datë 6.8.2007	Për disa shtesa në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, me ndryshime	3049
Udhëzim i MF nr.14, datë 6.8.2007	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.2, datë 30.1.2006 “Për procedurat tatimore”	3050
Udhëzim i MF nr.15, datë 6.8.2007	Për një ndryshim në udhëzimin nr.4, datë 30.1.2006 ”Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”	3055
Udhëzim i MF nr.16, datë 7.8.2007	Për një ndryshim në udhëzimin nr.1, datë 30.1.2006 “Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”	3055

UDHËZIM
Nr.13, datë 6.8.2007

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”,
ME NDRYSHIME**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat””, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Për prodhuesit, vendas e të huaj të mallrave, që përfshihen në Kodet e Nomenklaturës së Kombinuar; 22 03, 22 04, 22 05 dhe 22 08, të përfshira në kreun “III” të shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar”, vepohet si më poshtë:

1. Për prodhuesit vendas

Organet tatimore, në bazë të të dhënave të personave “tatimpagues të autorizuar të akcizës”, prodhues të mallrave të akcizës, sipas kodeve të Nomenklaturës së Kombinuar, të pajisur me “autorizim akcize” (sipas nenit 4 të ligjit të akcizave) dhe miratim të “magazinës tatimore” (sipas nenit 5 të ligjit të akcizave), mbas plotësimit të shtojcës 1 “Kërkesë për marrjen e autorizimit si tatimpagues akcize” dhe shtojcës 2 “Kërkesë për miratimin e magazinës tatimore” (të bashkëngjitura, sipas pikës 1.3 të udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003), përcaktojnë dhe shkallën tatimore që duhet të paguajnë prodhuesit e mallrave të akcizës, sipas shtojcës 1 të ligjit për akcizat.

Shembull:

- Personi “tatimpagues i autorizuar i akcizës”, prodhues i mallrave të akcizës dhe konkretisht “BIRRË” me kodin e NK 22 03, në rast se në shtojcën 1, si më sipër, ka parashikuar sasinë vjetore të prodhimit të birrës mbi 200.000 hektolitra në vit (vit kalendarik), do të paguajë shkallën tatimore prej 40 lekë për litër. Në rast të kundërt, do të paguajë 30 lekë për litër. Kjo do të zbatohet nga organet tatimore dhe për personat “tatimpagues të akcizës”, prodhues të mallrave të akcizës sipas kodeve të NK 22 04, 22 05, 22 08, të përcaktuara në ligjin e akcizave.

Për prodhuesit e huaj

• Personi i autorizuar nga organi tatimor si “tatimpagues i autorizuar akcize” që importon mallra akcize, dhe konkretisht “BIRRË” me kodin e NK 22 03, do të paraqesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave:

- Vërtetim, nga shoqëria prodhuese nga e cila do të importohet birra, për sasinë vjetore të prodhuar faktikisht në vitin e mëparshëm kalendarik. Në rast të mos paraqitjes së këtij vërtetimi, organet doganore, zhdoganimin e birrës do ta kryejnë me shkallën tatimore më të lartë, të përcaktuar në ligjin nr.9765, datë 9.7.2007 “Për akcizat”.

• Personi i autorizuar nga organi tatimor si “tatimpagues i autorizuar akcize” që importon mallra akcize, të cilat kërkojnë pullë akcize të Ministrisë së Financave, paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve:

- Vërtetim, nga shoqëria prodhuese nga e cila do të importohet vera dhe pijet alkoolike (pavarësisht se ku blihen këto mallra, në magazinat e shoqërisë apo në treg), për sasinë vjetore të prodhuar faktikisht në vitin e mëparshëm kalendarik. Në rast të mos paraqitjes së këtij vërtetimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve pajis me pulla akcize të Ministrisë së Financave, personat e autorizuar si “tatimpagues të autorizuar të akcizës”, me shkallën tatimore më të lartë, të përcaktuar në ligjin nr.9765, datë 9.7.2007 “Për akcizat”.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në të njëjtën datë me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9765, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.14, datë 6.8.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 30.1.2006
“PËR PROCEDURAT TATIMORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.9713, datë 16.4.2007, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.2, datë 30.1.2006 “Për procedurat tatimore” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2.3.3 në zbatim të nenit 41 të ligjit, riformulohet si më poshtë:

Për shkaqe që kanë të bëjnë me gjendjen e keqe të përkohshme financiare të tatimpaguesit, ky i fundit mund të kërkojë në formë shkresore të paguajë me këste një detyrim tatimor të papaguar.

Organet tatimore pranojnë pagesën me këste të detyrimit tatimor, duke hartuar në këtë rast një marrëveshje me shkrim me tatimpaguesit. Pagesa me këste nuk mund të pranohet për një periudhë me të gjatë se 9 muaj nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes. Në muajin e parë, pagesa e kështit për detyrimin tatimor nuk do të jetë më e vogël se 30 % e shumës së detyrimit gjithsej, ndërsa pjesa e mbetur paguhet për 8 muajt e tjerë. Pagesa me këste e një detyrimi tatimor, nuk ndërpret llogaritjen e interesave për të gjithë detyrimin. Pranimi nga organet tatimore i pagesës me këste të një detyrimi tatimor të papaguar, do të thotë se gjatë periudhës për të cilën është rënë dakord për pagimin me këste, ndaj tatimpaguesit nuk mund të merren masat e vjeljes me forcë të detyrimeve tatimore të përcaktuara në nenet 45 e 46 të ligjit (nxjerrja e vendimeve ekzekutive për bllokimin e llogarive bankare, sekuestrimin e pasurisë, mbylljen e veprimtarisë etj.). Këto masa merren vetëm pasi ka përfunduar afati për të cilin është pranuar pagesa me këste dhe, kur tatimpaguesi nuk ka respektuar derdhjen e kësteve në shumën e duhur dhe në afatin e caktuar.

2. Pika 3.1.2 “Dënimet për shkeljet lidhur me regjistrimin” në zbatim të nenit 49 të ligjit, riformulohet si më poshtë:

a) Në rastet kur tatimpaguesi ushtron aktivitet të peregjistruar në organet tatimore dhe pa u pajisur më parë me certifikatë tatimore, ndaj tyre fillimisht merret masa e bllokimit të veprimtarisë deri në momentin e regjistrimit dhe pajisjes me certifikatë nga organet tatimore. Në rastin e transportit, bllokimi i veprimtarisë shoqërohet edhe me marrjen e lejes së qarkullimit të automjetit të peregjistruar dhe të papajisur më certifikatë tatimore.

Brenda 5 ditëve nga marrja e lejes së qarkullimit nga organet tatimore, duhet të njoftohet zyrtarisht Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Në rast se tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë më parë masa e bllokimit të veprimtarisë gjendet duke ushtruar veprimtarinë, atëherë organet tatimore sekuestrojnë pasuritë në vendin e biznesit, sipas modelit të procesverbalit të sekuestrimit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b) Në rastet kur tatimpaguesi nuk ka njoftuar organin tatimor për ndryshimet e reja në regjistrim, të cilat kanë të bëjnë me adresën e vendit ku ushtrohet veprimtaria, dënohet me bllokim të veprimtarisë deri në momentin e regjistrimit të adresës së re të vendit ku ushtron veprimtarinë, si dhe pajisjen e tij me certifikatë dytësore regjistrimi (NIPT sekondar).

Në rastin e transportit, bllokimi i veprimtarisë shoqërohet edhe me marrjen e lejes së qarkullimit të automjetit të peregjistruar dhe të papajisur më certifikatë tatimore.

Brenda 5 ditëve nga marrja e lejes së qarkullimit nga organet tatimore, duhet të njoftohet zyrtarisht Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Në rast se tatimpaguesi ndaj të cilit është marrë më parë masa e bllokimit të veprimtarisë gjendet duke ushtruar veprimtarinë, atëherë organet tatimore sekuestrojnë pasuritë në vendin e ri të biznesit, sipas modelit të procesverbalit të sekuestrimit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Pika 3.1.5 “Dënimet për mosdokumentim”, riformulohet si më poshtë:

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave justifikohet në çdo rast me dokumentin përkatës. Për çdo rast shitjeje të mallrave, tatimpaguesi shitës është i detyruar të lëshojë dokumentet përkatëse të shitjes që janë:

- Kupon tatimor në rastin kur tatimpaguesi është i pajisur me arkë regjistruese. Ky kupon i jepet klientit për çdo shitje të kryer.

- Dëftesë tatimore në rastin kur tatimpaguesi nuk është pajisur me arkë regjistruese. Dëftesat tatimore përgatiten në dy kopje me letër vetëkopjuese nga të cilat njëra i jepet klientit.

- Faturë e thjeshtë tatimore, e cila lëshohet vetëm nga tatimpaguesit e taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të cilët shesin mallra apo shërbime për klientë, të cilët nuk janë konsumatorë finalë të mallit apo shërbimit, por i kryejnë këto blerje për qëllim përpunimi apo rishitje, pra janë subjekte të regjistruara për tatimet. Tatimpaguesi duhet t'i japë klientit një faturë për çdo shitje mallrash apo shërbimesh. Fatura do të përbëhet nga dy kopje duke përdorur letër vetëkopjuese ose letër karbon, dhe tatimpaguesi i jep një kopje klientit dhe një kopje e mban vetë. Fatura duhet të jetë me numër serial, dhe numri i faturës duhet të shënohet në librin e shitjeve dhe blerjeve.

- Faturë tatimore me TVSH, e cila lëshohet nga tatimpaguesit e regjistruar me TVSH, siç përcaktohet në ligjin mbi TVSH-në dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave në zbatim të tij.

Transportimi i mallrave justifikohet në çdo rast me dokumentin përkatës të shoqërimit. Për çdo rast që kemi të bëjmë me shitje të mallrave, tatimpaguesi shitës është i detyruar të lëshojë faturën përkatëse të shitjes, e cila në rastin kur shitësi është tatimpagues i regjistruar në TVSH do të jetë faturë tatimore me TVSH me numër serial dhe në rastin kur shitësi është tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, faturë e thjeshtë shitjeje, siç sqarohet më lart në pikën 3.1.5.

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave pa një nga dokumentet e mësipërme është shkelje dhe dënohet me sekuestrim të mallrave të padokumentuara, sipas modelit të procesverbalit të sekuestrimit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Kur nuk kemi të bëjmë me shitje të mallrave, por me lëvizje të brendshme të tyre (nga magazina në magazinë ose dyqan, nga qendra e tatimpaguesit drejt filialeve apo degëve të tij), lëvizja dokumentohet me dokumentin e shoqërimit të mallit, i cili do të ketë formën dhe përmbajtjen sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi, si dhe me një fotokopje të certifikatës dytësore të regjistrimit (NIPT sekondar).

Në rastet kur punonjësit e Policisë Tatimore dyshojnë për vërtetësinë e dokumentit të shoqërimit të mallit, ata marrin masa për të shoqëruar mallin deri në destinacionin e shënuar në dokument. Kur rezulton se tatimpaguesi në fakt mallin e kishte të destinuar për shitje (pra nuk kemi të bëjmë me shitje të brendshme), ai dënohet me sekuestrim të mallit.

4. Paragrafi i fundit në pikën 4.1.1 “Të drejtën e apelimit e ka çdo tatimpagues në lidhje:”, riformulohet si më poshtë:

- Me çdo vlerësim tatimor, me anë të të cilit janë përcaktuar detyrimi tatimor, interesat dhe gjobat;

- Me çdo vendim të organit tatimor, që ka të bëjë me pretendimin e tatimpaguesit për rimbursim apo përjashtim tatimor;

- Me çdo akt zyrtar të degës së tatimeve, që ka të bëjë me mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor dhe me bazën ligjore të përcaktimit të këtij detyrimi, si dhe ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të degës së tatimeve;

- Me çdo vendim ekzekutiv të posaçëm, që ka të bëjë me të.

Apelimi bëhet me shkrim dhe në krye të shkresës jepet shënimi “Kërkesë për apelim”.

Në kërkesën për apelim përcaktohen qartë:

- Të dhënat identifikuese të tatimpaguesit si emri, NIPT, dega e tatimeve ku është regjistruar, adresa (e tij ose e përfaqësuesit), numri i telefonit etj.

- Objekti i apelimit, lloji i detyrimit/detyrimeve që apelohe dhe shuma e detyrimit/detyrimeve që apelohe.

- Arsytet, argumentet dhe baza ligjore mbi të cilën apeluasi mbështetet për të kundërshtuar vendimin e organeve tatimore.

Kërkesa për apelim shoqërohet gjithmonë me kopjen e vlerësimit tatimor apo të çdo akti zyrtar të organit tatimor që tatimpaguesi kundërshton, dokumentin me anë të të cilit vërtetohet se është parapaguar shuma e detyrimit të vendosur, pa gjobat dhe interesat përkatëse, kur rasti është i tillë, si dhe çdo dokument tjetër që tatimpaguesi gjykon se është i nevojshëm për shqyrtimin e apelimit tatimor, si kopjen e aktit të kontrollit, kopjen e bilancit të veprimtarisë etj.

Për çdo apelim tatimor, tatimpaguesi duhet të paraqesë bashkëlidhur një kopje të përcaktimit të vlerësimit tatimor, aktin zyrtar ose vendimin e posaçëm ekzekutiv që ka të bëjë me tatimpaguesin.

Për apelimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, tatimpaguesit duhet të paraqesin njëkohësisht në degën përkatëse të tatimeve një kopje të kërkesës për apelim (pa dokumentet shoqëruese).

Apelimi paraqitet në shkallën më të ulët të sistemit të apelimit administrativ, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vlerësimit tatimor ose njoftimeve të tjera zyrtare, që lidhen me apelimin.

Data e marrjes së njoftimit të vlerësimit tatimor apo njoftimeve të tjera zyrtare, konsiderohet dita e dhjetë pas dorëzimit të njoftimit në shërbimin postar. Përgjegjësia për mosmarrjen në kohë të njoftimit të dorëzuar në shërbimin postar është e tatimpaguesit, i cili është i detyruar të deklarojë adresën e saktë të tij. Gjithashtu, administrata tatimore, mund të dorëzojë njoftimin e vlerësimit tatimor apo njoftimet e tjera zyrtare, dorazi. Në këtë rast, data e marrjes së njoftimit konsiderohet dita kur njoftimi i dorëzohet tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Në rastin e dorëzimit të njoftimeve dorazi, kur tatimpaguesi refuzon marrjen në dorëzim të tyre, datë e marrjes së njoftim vlerësimit tatimor apo i njoftimeve të tjera zyrtare, konsiderohet data kur tatimpaguesi ka refuzuar marrjen në dorëzim të tyre.

Organet tatimore përkatëse e shqyrtojnë kërkesën për apelim të tatimpaguesit dhe i kthejnë përgjigje atij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Datë e paraqitjes së kërkesës konsiderohet data në të cilën kërkesa për apelim është protokolluar në protokollin e organit ku bëhet apeliti. Në rast se dita e fundit e afatit 30-ditor bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e parë të punës që vjen pas asaj të pushimit.

Para se të paraqitet për apelim në shkallët e apelimit administrativ, tatimpaguesi është i detyruar të parapaguajë detyrimin tatimor që apelohe, pa përfshirë interesat dhe gjobat e mundshme që lidhen me këtë detyrim.

Në rast se tatimpaguesi do të apelojë në gjykatë, ai është i detyruar të parapaguajë 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të çdo gjobe dhe interesi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Drejtoria e Policisë Tatimore

0 0 0 0 0 0

PROCESVERBAL SEKUESTRIMI

I mbajtur sot më datë ____/____/____, ora ____ nga grupi i kontrollit të Policisë Tatimore
_____, në subjektin me adresë të
vendbiznesit _____ dhe aktivitet _____, ose mjeti me
targë _____, vendndodhje _____ pasi konstatoi se:

☐

Subjekti kryen aktivitet i paregjistruar në organin tatimor.

Në zbatim të pikës 1/b dhe 2/b të nenit 49 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.9713, datë 16.4.2007.

☐

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave pa dokumentacionin përkatës.

Në zbatim nenit 52 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.9713, datë 16.4.2007.

VENDOSI:

Sekuestrimin e menjëhershëm të pasurive në vendin e biznesit ose sekuestrimin e mallrave të padokumentuar (sipas listës bashkëlidhur).

Ky procesverbal mbahet në tre kopje.

PËR SUBJEKTIN

PËR POLICINË TATIMORE

1. _____

2. _____

3. _____

LISTA E MALLRAVE TË SEKUESTRUARA

[illegible]

PËR SUBJEKTIN

PËR POLICINË TATIMORE

1.

2. _____

3. _____

UDHËZIM
Nr.15, datë 6.8.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 30.1.2006 "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Pika 7 "Rimbursimi i kontributeve të paguara tepër", e udhëzimit nr.4, datë 30.1.2006 "Për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", ndryshohet si më poshtë:

1. Kthimi i shumave të paguara tepër ose rimbursimi i kontributeve

Në bazë të nenit 13 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nëse si rezultat i një kontrolli ose për arsye të tjera shuma e kontributeve të paguara tejkalon shumën e llogaritur të detyrimeve për kontributet, dega përkatëse e tatimeve, rimbursion diferencën brenda 30 ditëve nga zbulimi i mbipagesës ose nga paraqitja e kërkesës me shkrim prej tatimpaguesit.

Kthimi i shumave të paguara më tepër ose rimbursimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mund të bëhet në një nga format e mëposhtme:

a) duke e kaluar shumën e paguar më tepër të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për llogari të pagimit të detyrimeve të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore ose shëndetësore;

b) duke e kaluar shumën e paguar më tepër të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me pëlqimin e tatimpaguesit, për llogari të pagimit të detyrimeve të mëvonshme të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

c) duke e kaluar shumën e paguar më tepër në llogarinë e tatimpaguesit.

Nëse të gjitha ose pjesë të kontributeve të paguara lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi është përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të përcaktojë rregullat për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.16, datë 7.8.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 30.1.2006 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, datë 22.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

I: Pika 2.5 "Taksa e importimit të automjeteve të përdorura" e udhëzimit nr.1, datë 30.1.2006 "Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë" riformulohet si më poshtë:

"2.5 Taksa e importimit të automjeteve të përdorura

"Agjent tatimor për vjeljen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura janë degët doganore në pikat e kalimit të kufirit. Kjo taksë paguhet nga importuesi i automjetit në momentin e zhdoganimit të tij. Degët doganore bëjnë llogaritjen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura

sipas llojeve të mjeteve:

2.5.1 Për autoveturat, llogaritja e taksës bëhet sipas pikës 5.3 të nenit 2 të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, datë 22.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Llogaritja e taksës bëhet sipas formulës:

Taksa fikse x Cilindrata e motorit x Koeficienti i viteve të përdorimit.

Taksa fikse për autoveturat me naftë është 25 mijë lekë, ndërsa për autoveturat me benzinë 20 mijë lekë.

Cilindrata e motorit është volumi i dhomës së djegies së motorit e shprehur në centimetër kub dhe jepet në certifikatën shoqëruese të mjetit.

Vite përdorimi quhen diferenca ndërmjet vitit kur mjeti hyn në doganën shqiptare dhe vitit të prodhimit.

Shembull 1: Llogaritja e taksës për një autoveturë tip benz 190 i prodhuar në vitin 2002 me naftë dhe i importuar në vitin 2007, bëhet si më poshtë:

- Koeficienti sipas ligjit është 0.0029;
- Cilindrata e motorit është 1930 centimetër kub;
- Taksa fikse 25 mijë lekë;
- $1930 \times 25000 \times 0.0029 = 139.925$ lekë.

Shembull 2: Llogaritja e taksës për një autoveturë, e cila në momentin e zhdoganimit ka mbi 10 vjet prodhimi, për të njëjtin tip autoveture si në shembullin e mësipërm, bëhet si më poshtë:

- $1930 \times 25000 \times 0.0048 = 231.600$ lekë.

Në çdo rast, llogaritja e taksës së importimit të autoveturave të përdorura, do të bëhet sipas formulës së pikës 5.3 të ligjit. Në qoftë se nga llogaritjet sipas pikës 5.3 të ligjit, taksa e importimit të autoveturave të përdorura rezulton më e vogël se nivelet e parashikuara në pikat “5.1.a” dhe “5.2.a” të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007, taksa do të mbahet sipas këtyre pikave.

2.5.2 Për mjetet e tjera të transportit, llogaritja e taksës është e diferencuar sipas vitit të prodhimit, për 10 ose më shumë vite prodhimi dhe për më pak se 10 vite prodhimi. Taksa është fikse sipas llojit të mjetit e përcaktuar në pikën 5 të nenit 5 të ligjit.

Degët e doganës të gjitha arkëtimet nga taksat i evidentojnë në regjistër, sipas formularit nr.6 bashkëngjitur udhëzimit nr.1, datë 30.1.2006.”.

II: Në pikën 2.4 “Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja” në krye të saj shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Autoveturat e huaja, të përfshira në pikën 1 të lidhjes 4 të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përjashtohen nga pagesa e taksës së qarkullimit për 60 ditë qëndrimi në vit në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe paguajnë vetëm 1 euro në çastin e daljes. Për çdo ditë qëndrimi mbi këtë periudhë, taksa e qarkullimit llogaritet sipas lidhjes nr.4 të ligjit të cituar më lart.

Shembull:

Një autoveturë e huaj që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 15 korrik 2007 dhe do të dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë në datën 15 gusht 2007 do të paguajë:

- a) për periudhën deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007:

$21 \text{ ditë} \times 1 \text{ euro/ditë} = 21 \text{ euro}$

b) për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007, deri në datën 15 gusht 2007 (pra brenda 60 ditëve) do të paguajë shumën prej 1 euro.

- c) pagesa gjithsej e taksës $21 \text{ euro} + 1 \text{ euro} = 22 \text{ eurosh}$.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare, dhe hyn në fuqi në të njëjtën datë me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9769, datë 9.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, datë 22.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 7.8.2007
 Doli nga shtypi më 7.8.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
 Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë